



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORTI I AZHURNIMEVE PËR INVESTIMET KAPITALE TË KEK SH.A

DEKLARATË

Ky raport është përgatitur nga ZRRE me qëllim të informimit të palëve të interesit. [Raporti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.](#)

Prill 2017



Përmbajtje

1	Hyrje	4
2	Investimet e lejuara dhe përshtatjet e rregullta	5
2.1	Metodologjia.....	5
2.2	Procesi i përshtatjeve të rregullta.....	6
2.3	Aplikacioni i KEK – SHTE11	6
2.4	Investimet kapitale të KEK	7
2.5	Akumulimi i zhvlerësimit dhe kthimit për investimet e përealizuara	8
2.5.1	Mënyra e përshtatjes	8
	SHTOJCA 1 Trendi i çmimeve të energjisë me shumicë	10



Përmbledhje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është aktualisht duke i zhvilluar proceset e Përshtatjes së Rregullimit dhe Azhurnimit Vjetor të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të Kompanive të Rregulluara në Sektorin e Energjisë Elektrike në kuadër të Shqyrtimit të Njëmbëdhjetë të Tarifave të Energjisë Elektrike. Rrjedhimisht, ZRRE do të azhurnojë MAR e Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPPE) dhe do të përshtatë MAR e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) si dhe do të bëjë azhurnimin e shpenzimeve të amortizimit të pranuar nga KEK për investimet bazuar në vlerat e caktuara në Shqyrtimin Periodik të bërë në kuadër të SHTE7 (2013-2017).

Ky raport përshkruan mënyrën e azhurnimeve për KEK Sh.A si dhe të përmbylljes së rregullimit të çmimeve për gjenerimin e energjisë elektrike. Dokumentet relevante me këtë raport mund të gjinden në tabelën më poshtë:

Dokumente Relevante

Udhëzuesi për Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Republikën e Kosovës	http://ero-ks.org/2017/AktetUdhezimet/Udhezuesi_per_Liberalizim_Tregu_2017.pdf
Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së të MAR të KEK-ut në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/Vlersimi_perfundimtar_per_Gjenerim_22Mars2013.pdf
Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale dhe Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar – SHTE8	http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Raporti_Vlersues_per_MAR_dhe_Ngarkesat_e_Gjenerimit.pdf
Vlerësimi i ndikimit në të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe rishqyrtimi tarifor – Shqyrtimi I jashtëzakonshme	http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Raport_vlersues_shqyrtimi_i_jashtzakonshem_10_8_2014.pdf
Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) dhe Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar – SHTE9	http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Gjenerimi_Raport_konsultativ_06_03_2015.pdf
Llogaritja e të Hyrave të Maksimale të Lejuara (MAR) dhe Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar – SHTE10	http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Gjenerimi_Raport_Konsultativ_22_02_2016.pdf
Raport Monitorues për KEK (2013-2015)	http://ero-ks.org/2016/Raportet/RAPORT_MONITORIMI_KEK_Investimet_kapitale_shpenzimet_operative_dhe_performanca_per_periudhen_2013_2015.pdf



1 Hyrje

Zhvillimet e fundit në sektorin e energjisë që lidhen me liberalizimin e tregut, dalin të jenë komplekse në këtë periudhë. Përkundër vështirësive, qëndrimet e ZRRE-së janë që ky proces i cili tashmë ka filluar, duhet të vazhdojë në mënyrë graduale dhe në bashkëpunim me të gjithë aktorët në sektorin e energjisë. Një nga hapat kyç është derregullimi i çmimit të gjenerimit, i cili është definuar me legjislacionin primar.

Prandaj si rezultat i këtyre ndryshimeve, Bordi i ZRRE-së, paraprakisht ka nxjerrë “Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Republikën e Kosovës” si dhe ka dërguar një Letër orientuese për të licencuarit, në mënyrë që KEK dhe palët tjera në treg të cilat do të merren me shitblerjen e energjisë me shumicë, të kenë alternativa orientuese për të arritur marrëveshje të ndërsjella. Kështu, disa nga kushtet e derregullimit të çmimeve me shumicë dhe pakicë do të derrogohen edhe për një muaj, ku ZRRE ka përcaktuar muajin prill 2017, si muajin ku duhet të arrihen të gjitha marrëveshjet në mes palëve për shitblerjen e energjisë me shumicë, dhe të gjitha këto marrëveshje do të kenë efekt retroaktiv nga data 1 prill 2017. E gjithë kjo është bërë për arsyen e mosfunksionimit efektiv të tregut të energjisë dhe koncentrimin të lartë të një furnizuesi në tregun me pakicë.

Në Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut, ZRRE ka përcaktuar disa kritere bazë të trajtimit të energjisë me shumicë, derregullimit të çmimeve dhe azhurnimin për amortizimin e akumuluar për periudhën 2013-2016 nga KEK Sh.A.



2 Investimet e lejuara dhe përshtatjet e rregullta

2.1 Metodologjia

Në sektorët e rregulluar, të Hyrat e Lejuara Maksimale përcaktohen nga rregullatori në mënyrë që të licencuarit ti mbulojnë kostot e tyre të arsyeshme për ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Tarifat (çmimet) dizajnohen ashtu që të mbulojnë kostot për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Ne kuadër të të hyrave të lejuara janë edhe kostot që kanë të bëjnë me investimet kapitale. Metodologjia në bazë të cilës njihen kostot e të licencuarve përmbajnë elemente të cilat nxisin operatorët që të bëjnë investimet e duhura duke i mundësuar kthim të arsyeshëm për investimet e bëra.



Figura 1- Skema e kthimit në sektrin e rregulluar

Norma e kthimit (WACC) aprovet nga rregullatori dhe aplikohet më pastaj ndaj vlerës së investimeve kapitale (CAPEX-it) për të kalkuluar kthimin e lejuar.

Duke qenë ky sektor i rregulluar, ZRRE siguron që interesat e kompanisë dhe konsumatorëve të jenë të balancuara. Norma e kthimit për investime aprovet nga rregullatori për periudhë rregullative (4-5 vite) dhe ajo garanton që operatori të sigurojë fitim të rregulluar të arsyeshëm dhe konsumatorët të përfitojnë në kualitetin e shërbimit.

Me poshtë është paraqitur figurativisht nxitja e investimeve përmes normës së kthimit dhe balancimi i interesave ndërmjet kompanisë dhe konsumatorëve nëpërmjet rregullimit.




Figura 2-Rregullimi



2.2 Procesi i përshtatjeve të rregullta

Në vitin 2013 ZRRE ka kryer Procesin e Shqyrtimit Periodik (SHTE7) ku ndër tjera ka caktuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për katër Vitet e ardhshme Relevante për Gjeneratorin e Rregulluar (KEK). Sipas Rregullave të Vendosjes së Çmimeve, proceset e Përshtatjes së Rregullt duhet të kryhen për çdo Vit Relevant të Periudhës Rregullative në mënyrë që të llogariten ndryshimet në mes të atyre të lejuara dhe të realizuara. Procesi i Përshtatjes së Rregullt dallon nga Shqyrtimi Periodik i plotë në të cilin ZRRE do të bënte një shqyrtim të detajuar të Kostove të Lejuara të Operimeve dhe Mirëmbajtjes, humbjeve të lejuara dhe faktorëve të efikasitetit dhe të Shpenzimeve Kapitale të lejuara. Në vend të saj, gjatë Përshtatjeve të Rregullta, ZRRE vetëm përshtat në mënyrë mekanike dallimet në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara nga ato që veç janë lejuar gjatë Shqyrtimit Periodik.

Duke u nisur nga fakti që më 31 mars 2017 ka përfunduar periudha shumëvjeçare për KEK Sh.A. dhe fakti i derregullimit të çmimeve të gjenerimit të definuar me ligjet në fuqi, ZRRE duhet të bëjë përshtatjet për investimet e lejuara dhe realizuara nga KEK (ku përfshihen investimet në TC Kosova A, TC Kosova B dhe Mihjet), duke kompensuar konsumatorët për zhvlerësimin dhe kthimin në investime të parealizuara të pranuar nga KEK. Ky kompensim do të përshtatet për normën e interesit të përcaktuar si vlerë hyrëse gjatë periudhës rregullative.

2.3 Aplikacioni i KEK – SHTE11

Zyra e rregullatorit për energji ka hapur procesin për Azhurnimet vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe tarifat/ngarkesat e energjisë elektrike për të gjithë të licencuarit më datë 30 dhjetor 2016.

Në raport me kërkesat e ZRRE-së ndaj KEK për procesin e aplikimit, njoftimi për fillimin e procesit të azhurnimeve të rregullta përmban:

- *Duke ju referuar Udhëzuesit si dhe rregullave për vendosjen e çmimit, ZRRE do të përmbyllë rregullimin e çmimit të Gjenerimit të energjisë elektrike nga KEK Sh.A. duke bërë edhe azhurnimet e fundit për Periudhën Rregullative Shumëvjeçare e cila për KEK Sh.A. përfundon më 31 mars 2017.*
- *Si rrjedhojë, ZRRE kërkon nga KEK Sh.A. që të paraqes të gjitha kostot aktuale, duke përfshirë kostot operative dhe të mirëmbajtjes si dhe kostot kapitale, bazuar në lejimet nga ana e ZRRE për periudhën rregullative 2013-2016 dhe siç është përcaktuar me rregullat për vendosjen e çmimeve të Gjenerimit.*

KEK ka dorëzuar me vonesë të dhënat e kërkuara sipas njoftimit të dërguar nga ZRRE, bazuar në rregullat e çmimeve të Gjenerimit, e cila ka shkaktuar një vonesë në vendimin e Bordit të ZRRE në lidhje me përmbylljen e Periudhës Rregullative. Një pengesë tjetër është paraqitur edhe nga mungesa e një marrëveshje për shitblerje të energjisë në mes të palëve në treg.

Më datë 4 prill 2017, KEK ka dërguar të dhënat në lidhje me realizimin e investimeve të lejuara për periudhën 4 vjeçare rregullative.



ZRRE ka shqyrtuar të dhënat e pranuar nga KEK dhe ka analizuar me kujdes ndikimin e realizimit/mosrealizimit të investimeve kapitale në aspektin tarifor të sektorit. Një nga parimet bazë të rregullimit në sektorin e energjisë është reflektimi real i kostove të arsyeshme të sistemit në tarifën dhe çmimet e energjisë. Si rrjedhojë, çdo ngarkesë ndaj konsumatorëve të energjisë elektrike për kosto të përcaktuara, duhet të kthehet konsumatorëve të përshtatur për normën e interesit të përcaktuar në Shqyrtimin Periodik.

ZRRE do të respektoj parimet bazë të rregullimit edhe në rastin e KEK, mirëpo do të jetë fleksibile në kohën për të cilën duhet të kompensoj konsumatorët për investimet e përcaktuara. Për të ardhur deri tek një propozim i arsyeshëm për aprovim të Bordit, ZRRE ka shqyrtuar disa nga alternativat e mundshme dhe ka propozuar mënyrën më të arsyeshme të kompensimit, në mënyrë që KEK të ketë likuiditet në mbulimin e këtij kompensimi.

2.4 Investimet kapitale të KEK

ZRRE ka lejuar investime kapitale të konsiderueshme për periudhën rregullative 2013-2016, të cilat do të ndikonin në përmirësimin e performancës së sistemit energjetik në përgjithësi dhe të gjeneratorëve në veçanti. Vlera e përgjithshme e investimeve të lejuara në KEK janë 208.4 milion €, ku përfshihen investimet në: TC Kosova A, 58.4 milion €; TC Kosova B, 44.1 milion €; dhe Mihje 105.9 €.

Me qëllim të fleksibilitetit në implementimin e investimeve të lejuara, të licencuarve, duke përfshirë edhe KEK-un, i'u është lejuar që investimet të realizojnë përgjatë periudhës rregullative, ndërsa azhurnimi i zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar të bëhet në fund të periudhës rregullative shumëvjeçare, e cila konsiderohet si kohë e arsyeshme për realizimin e investimeve të cilat fillimisht janë të planifikuara nga vet KEK-u dhe të lejuara nga ZRRE.

Të dhënat e dërguara nga KEK dhe të vërtetuara nga ZRRE, paraqesin një gjendje jo të kënaqshme në aspektin e investimeve të realizuara për periudhën 4 vjeçare të rregullimit. **Nga vlera e përgjithshme e lejuar e investimeve, KEK në të gjitha divizionet, ka realizuar 101.4 milion €, apo shkrehur në përqindje, 48.7%.** Investimet e realizuara nga KEK, përmbajnë edhe projekte të cilat nuk janë lejuar gjatë shqyrtimit periodik, mirëpo kanë lindur si pasojë e avarisë në TC Kosova A, vlera e të cilave rezulton të jetë 2.7 milion €.

Në tabelën në vijim është i paraqitur raporti në mes të investimeve të lejuara dhe atyre të realizuara sipas viteve (2013-2016).



INVESTIMET NË KEK PËR PERIUdhËN SHUMËVJEÇARE								
Viti	MIHJE		TC KOSOVA A		TC KOSOVA B		Total	
	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)	Të lejuara (€ mil)	Të realizuara (€ mil)
2013	14.51	8.44	23.02	30.46	9.07	1.87	46.60	40.77
2014	39.95	10.44	17.71	9.81	5.50	9.19	63.16	29.45
2015	41.45	6.19	10.21	8.87	16.50	6.04	68.16	21.10
2016	9.95	5.92	7.50	2.60	13.00	1.60	30.45	10.12
Total	105.87	30.98	58.44	51.74	44.07	18.71	208.38	101.43

Tabela 1 – Investimet në KEK për periudhën katër vjeçare

2.5 Akumulimi i zhvlerësimit dhe kthimit për investimet e parealizuara

ZRRE gjatë Shqyrtimit Periodik ka lejuar të Hyrat e Lejuara Maksimale të KEK për një periudhë katër (4) vjeçare, të cilat përfshijnë edhe investimet. Investimet janë lejuar që të realizohen përgjatë gjithë periudhës 4 vjeçare, duke mos bërë përshtatjet për mosrealizimin eventuale në ndonjë vit të veçant, në mënyrë që KEK të ketë mundësi në vitin vijues të realizoj investimet edhe për vitin paraprak.

Meqenëse periudha 4 vjeçare e rregullimit të tarifave dhe çmimeve të KEK ka përfunduar më 31 mars 2017, atëherë ZRRE do të bëjë përshtatjet për investimet kapitale duke kompensuar konsumatorët fundorë për zhvlerësimin dhe kthimin për investimet e KEK dhe të përshtatur për interes, të paguar përmes tarifave me pakicë të konsumatorëve fundorë me energji elektrike.

ZRRE ka kryer të gjitha kalkulimet e nevojshme nga të cilat zhvlerësimi dhe kthimi, të përshtatur për interes, për periudhën rregullative 2013-2016, rezulton të jetë **21,534,381 €**. Në këtë version janë konsideruar të gjitha investimet e KEK, pavarësisht a kanë qenë të lejuara paraprakisht nga ZRRE apo jo.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur vlerat nëpër vite të zhvlerësimit dhe kthimit për investimet e parealizuara të KEK-ut, duke njohur edhe investimet e palejuara paraprakisht si të mirëqena.

ZHVLERËSIMI DHE KTHIMI NË INVESTIME TË PAREALIZUARA				
Viti	MIHJE (€ mil)	TC KOSOVA A (€ mil)	TC KOSOVA B (€ mil)	Total (€ mil)
2013	0.26	-0.62	-0.26	-0.63
2014	-1.42	-0.73	-0.50	-2.65
2015	-4.12	-1.10	-0.76	-5.98
2016	-5.93	-1.49	-1.95	-9.37
Total zh+k	-11.21	-3.95	-3.47	-18.63
Interesi	-1.75	-0.62	-0.54	-2.90
Total + i	-12.96	-4.56	-4.01	-21.53

Tabela 2 – Zhvlerësimi dhe kthimi për investimet e parealizuara

2.5.1 Mënyra e përshtatjes

Një nga parimet bazë të rregullimit është mbulimi i kostos së arsyeshme të sistemit energjetik nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike. Në rastet kur të licencuarit përfitojnë më tepër se



kostot e tyre, atëherë në periudhën në vijim do ti kompensojnë konsumatorët për pjesën të cilën janë ngarkuar përmes tarifës dhe për të cilën nuk kanë pasur asnjë përfitim, si dhe anasjelltas.

ZRRE ka analizuar disa mënyra të përshtatjes së kostos kapitale të KEK-ut, në mënyrë që të kompensohen të gjithë konsumatorët të cilët kanë paguar këto kosto përgjatë viteve 2013-2016, përmes faturave të energjisë elektrike. Meqenëse tani veç ka filluar derregullimi i çmimeve me pakicë të konsumatorëve industrial dhe komercial të kyçur në nivelin 220kV dhe së shpejti do të mund të derregullohen çmimet për konsumatorët e kyçur në nivelin 110 kV si dhe konsumatorëve tjerë, kompensimi përmes furnizuesit do të jetë shumë e vështirë të realizohet. Mënyra më e drejtë e kompensimit të konsumatorëve është përmes Sistemit të Transmetimit, ku do të përfitonin të gjithë konsumatorët pavarësisht nivelit të tensionit dhe nivelit të rregullimit.

KEK Sh.A. duhet të kthej të hyrat për pjesën e amortizimit dhe kthimit të pranuar për investimet e përfunduar, të përshtatur për interes, brenda një periudhe prej dy (2) vitesh. KEK do të furnizojë KOSTT me energji për nevojat e Sistemit të Transmetimit, në formë të kompensimit për konsumatorët. Sasia e parashikuar e nevojave të Sistemit të Transmetimit (për mbulimin e humbjeve) për energji për vitin rregullativ 2017/2018 do të jetë 360 GWh. Nëse kjo energji do të llogaritet me një çmim prej 35.4 €/MWh do të rezultonte në një vlerë prej 12.8 milion €. KEK duhet të furnizojë të paktën 302 GWh për KOSTT-in, në mënyrë që të kompensojë 10.7 milion € në vitin e parë (2017/2018) nga shuma e përgjithshme që duhet të kthehet. Pjesa e mbetur nga vlera prej 21,5 milion €, do të kthehet në vitin e dytë, duke marrë parasysh, sasinë e energjisë dhe çmimet e tregut për blerjen e energjisë.



SHTOJCA 1

Trendi i çmimeve të energjisë me shumicë

Me qëllim të një pasqyre më të qartë rreth të hyrave të mundshme të KEK, nga shitja e energjisë në tregun me shumicë, janë bërë analiza rreth trendit të çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare dhe rajonale. Çmimet e energjisë me shumicë, vitet e fundit kanë pësuar një rënie të ndjeshme si pasojë e rënies së çmimeve të derivateve të naftës dhe gazit në bursat ndërkombëtare, dhe të cilat në disa raste i afrohen nivelit të çmimeve historike të gjenerimit në Republikën e Kosovës.

Në figurën 3, është paraqitur trendi i çmimeve të energjisë me shumicë, sipas ngarkesës bazë në Bursën e Energjisë Evropiane (EEX), e cila është përzgjedhur si një ndër bursat më të besueshme të tregtisë me energji në Evropë. Nga grafiku shihet që nga viti 2012 ku çmimi mesatar ishte mbi 50 €/MWh, në vitin 2016 çmimet sillen prej 25-32 €/MWh, ndërsa edhe për vitin 2017 çmimet pritet të jenë të ngjashme.




Figura 3 - Trendi i çmimeve të energjisë me shumicë në EEX sipas ngarkesës bazë

Ndërsa në figurën 4, është paraqitur trendi i çmimeve të energjisë me shumicë në EEX, sipas ngarkesës së pikut. Nga grafiku shihet që nga viti 2015, çmimet mesatare sillen në mes të 27 e 40 €/MWh.

¹ Burimi: EEX - <https://www.eex.com/en/market-data/power/futures/phelix-futures#!/2017/04/07>




Figura 4 - Trendi i çmimeve të energjisë së pikut në EEX